



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVES
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
Hajvali - Prishtine



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Nr. / Br. 01/02/2004/1
Data / Datum 30.10.2024



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs
Inspektorati Policor i Kosovës-Police Inspectorate of Kosova- Policijski Inspektorat Kosova
Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv - Office of the Executive Chief - Ured Izvršnog Šefa

DATË/A:	30.10.2024
REFERENC-Ë:	IPK/30102024/ KH
PËR/ZA/TO:	z. Xhelal Sveçla, Ministër i MPB-së
CC:	znj. Ibadete Mehmeti, Zv. Drejtore e Departamentit për Reformën e Administratës Publike, MPB
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv - IPK
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i Performancës i IPK -së për vitin 2025

I nderuar Ministër z. Sveçla ,

Në përputhje me Rregulloren (QKR) nr.12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, ju njoftojë se më datën 30 tetor 2024, Inspektorati Policor i Kosovës ka hartuar Planin e Performancës për vitin 2025.

Bashkangjitur gjeni Planin e Performancës për vitin 2025, si dhe Tabelën e Planit të Veprimit nga IPK.

Për sqarime dhe informacione shtesë për t'a finalizuar si dokument siç e parasheh Rregullorja përkatëse jemi të hapur për diskutim dhe sqarime. Andaj, ju lutem të na kontaktoni.

Me respekt;



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs
Inspektorati Policor i Kosovës-Police Inspectorate of Kosova- Policijski Inspektorat Kosova
Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv - Office of the Executive Chief - Ured Izvršnog Šefa

PLANI I PERFORMANCËS 2025



(tetor 2024)

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT.....	3
PARATHËNIE.....	4
HYRJE.....	5
MISIONI.....	6
I. Përmbledhja e objektivave.....	6-6
II. Treguesit matës në arritjen e objektivave.....	7-7
III. Vlera bazë dhe vlera e synuar.....	8-8
IV. Outputet.....	8-8
V. Aktivitetet	8-11
VI. Alokimi Financiar.....	11-11
VII. Referenca në dokumente strategjike/politike.....	11-11

Anex- Tabela e Planit të veprimit

SHKURTESAT

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
PK	Polica e Kosovës
DH	Departamenti i Hetimeve
DI	Departamenti i Inspektimeve
DPBÇI	Departamenti për Planifikim Bashkëpunim Çështje ligjore dhe Informim
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
PK	Policia e Kosovës
EPAC	European Partners Against Corruption
NIAIA	National Internal Affairs Investigation Associations
AQP	Autoriteti Qendror i Prokurimit
PKZH	Plani Kombëtar për Zhvillim
PZHS	Plani Zhvillimor Strategjik

Parathënie

Inspektorati Policor i Kosovës është agjenci ekzekutive e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe është e organizuar në pajtim me Ligjin nr.03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës ku objekt i veprimtarisë së saj është:

- 1.1. parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj,
- 1.2. inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standard të operimit në fuqi,
- 1.3. hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës, siç është e përcaktuar në nenin 4, paragraf 1.nën-paragrafi 1.1 të Ligjit për IPK-në,
- 1.4. hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv,
- 1.5. zhvillimi i hetimeve disiplinore për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë kur ka dyshime të bazuara se ka kryer shkelje disiplinore, hetime të cilat bëhen me autorizim nga Kryeministri,
- 1.6. pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga IPK dhe cilat i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

IPK, bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë themelore të saj të përcaktuara në Ligjin për IPK-së, Planin e Performancës për vitin 2025, e ka përgatitur në përputhje me Planin Kombëtar për Zhvillim 2024-2026 (më tutje: PKZH 2024-2026), si dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në Rregulloren (QKR) nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore. Po ashtu Plani i Performancës është i mbështetur edhe në Planin Zhvillimor Strategjik 2022-2024¹, aktivitete të cilat do të inkorporohen në Planin Zhvillimor Strategjik i cili do të hartohet në vitin 2025.

¹ Disa nga aktivitetet e përcaktuara në Planin Zhvillimor Strategjik 2022-2024, do të inkorporohen edhe në Planin Zhvillimor strategjik 2025-2027, e të cilat aktivitete do të vendosen si të paraprirë në Planin e Performancës 2025.

Hyrje

IPK, ka hartuar Planin e Performancës, duke u bazuar në Rregulloren (QKR) nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore e cila buron nga Ligji nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Plani i Performancës të IPK-së, ndërlidhet me objektivat e përcaktuar në PKZH 2024-2026, si dhe ato të Planit Zhvillimor Strategjik 2022-2024, të cilat do të inkorporohen në Planin Zhvillimor Strategjik 2025-2027 të cilat objektiva do të jenë të vendosura duke qenë si të paraprirë në këtë Plan të Performancës.

Me qëllim të ngritjes së performancës të IPK-së, në këtë Plan të Performancës janë planifikuar katër objektiva, të cilat konsiderohen të domosdoshme që janë hartuar sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe Rregulloren (QKR)nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore.

Vlen të theksohet që aktivitetet e përcaktuara për arritjen e objektivave përfshijnë të gjithë strukturën organizative të IPK-së e të cilat janë të ndara si më poshtë:

Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv;
Departamenti i Hetimeve;
Departamenti i Menaxhimit të Ankesave;
Departamenti i Inspektimeve;
Departamenti për Planifikim Bashkëpunim Çështje Ligjore dhe Informim;
Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.

Rrjedhimisht, Plani i Performancës 2025, është në funksion të zbatimit sa më eficient të misionit të IPK-së, i cili konsiston në sigurimin e shërbimeve policore transparente, të përgjegjshme dhe demokratike sipas standardeve ndërkombëtare.

Për realizimin e këtij Plani të Performancës për vitin 2025, IPK mund të sfidohet nga faktorët e brendshëm dhe ata të jashtëm. Si sfidë e brendshme mund të konsiderohet mungesa e Burimeve Njerëzore për shkak të ngarkesës në punë dhe rritjes në vazhdimësi të numrit të ankesave të qytetarëve që duhen trajtuar, mungesa e pajisjeve teknike për hetime dhe zbatim të masave të fshehta, për kryerjen me sukses të mandatit ligjor në hetimet penale, si dhe zhvendosja e selisë në qytet, që është edhe një nga sfidat e IPK-së. (zhvendosja e selisë së IPK-së në qendër, ka qenë në vazhdimësi rekomandim i partnerëve ndërkombëtar si dhe i Komisionit Parlamentar për Siguri). Në pamundësi të gjetjes së ndonjë zgjidhje për ndërrim të objektit, duhet të mendohet për një zyrë të ankesave në Prishtinë.

Ndërsa, si sfida që ndikohen nga faktorët e jashtëm mund të jenë aktivitete për të cilat është e domosdoshme zhvillimi i procedurave të prokurimit të cilat duhet kryhen nga ana e Autoritetit Qendror të Prokurimit (AQP).

Misioni

Sigurimi i shërbimeve policore transparente, të përgjegjshme dhe demokratike sipas standardeve ndërkombëtare.

1. Përmbledhja e objektivave

Objektivat e përcaktuara për vitin 2025 për IPK janë:

Ngritja dhe Profesionalizmi i punonjësve dhe fuqizimi i kapaciteteve të IPK-së;

Sigurimi i transparencës së vazhdueshme lidhur me fushëveprimin ligjor të IPK-së;

Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në trajtimin e ankesave si dhe parandalimin dhe hetimin e veprave penale, shkeljeve disiplinore si dhe inspektimeve të realizuara sipas kompetencave ligjore të IPK-së;

Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Përmes këtyre objektivave synohet përmbledhja e të gjitha aktiviteteve përmes së cilave do të arrihen synimet në përmbushjen e mandateve të IPK-së.

Duke marrë në konsideratë që në përputhje me fushëveprimtarinë e institucionit transparenca zbatohet për t'u siguruar të gjithë të interesuarve që të kenë informacion gjithëpërfshirës për rezultatet gjatë procesit të punës së institucionit, gjë e cila u mundëson palëve të interesuara dhe qytetarëve në përgjithësi që të kuptojnë më qartë veprimet dhe shërbimet që i zhvillon institucioni.

Gjithnjë bazuar në kërkesat e parapara ligjore, ankesat shërbejnë si një mënyrë e rëndësishme përmes së cilës pranimi dhe shqyrtimi i tyre nga IPK-ja, do të ndikojë në krijimin e besimit dhe nxitjes së qytetarëve për të informuar sjelljet që bien kundërshtim me parimet ligjore nga ana e punonjësve të PK. Për më tutje, parandalimi i krimit luan rol të rëndësishëm pasi që përmes tij tentohet të eliminohet krimi përpara se të ndodhë ose përpara se të rezultojë se do të ketë ndonjë aktivitet shtesë. Hetimi si qëllim ka shqyrtimin e plotë të pretendimeve si dhe ekzaminimin e të gjitha provave relevante duke arritur në konkludim nëse është kryer ndonjë vepër penale apo disiplinore nga ana e punonjësve policor bazuar në legjislacionin në fuqi.

Ndërsa globalizimi në të gjitha sferat e jetës, nga e cila preken edhe institucionet e zbatimit të ligjit e në veçanti IPK me fushëveprimtarinë e saj e shtynë atë që të bashkëpunojnë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në mënyrë që të ofrojë dhe t'i vë në dukje rezultatet e punës së saj.

2. Treguesit matës në arritjen e objektivave

Objektivi 1. Ngritja dhe profesionalizmi i punonjësve dhe fuqizimi i kapaciteteve të IPK-së

Referuar aktiviteteve të potencuara për përmbushjen e aktiviteteve do të hartohet një dokument, ndërsa aktivitet tjera do të hyjnë në kategorinë e treguesit që janë (nën përjashtimin e vlerës) PO/JO.

Objektivi 2. Të sigurohet transparencë e vazhdueshme lidhur me fushëveprimin ligjor të IPK-së

Referuar aktiviteteve të potencuara për përmbushjen e aktiviteteve do të bëhet publikimi një-vjeçar i revistës “Integriteti” dhe i gjashtë (6) buletineve “Linja e kaltër, publikimi i raporteve të inspektimit dhe varësisht nga kërkesa në shërbime do të realizohen aktivitetet për të ofruar informata që janë në interes të publikut dhe njoftim të ankuesve lidhur me statusin e ankesave që janë trajtuar, por aktivitetet në përgjithësi hyjnë në kategorinë e treguesit që janë (nën përjashtimin e vlerës) me PO/JO.

Objektivi 3. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në pranimin e ankesave si dhe parandalimin, hetimin e veprave penale, shkeljeve disiplinore si dhe inspektimeve sipas kompetencave ligjore të IPK-së

Duke pasur në vëmendje dhe konsideratë të natyrës së veprimtarisë së institucionit, aktivitetet e këtij objektivi në përgjithësi hyjnë në kategorinë ku treguesit janë (nën përjashtimin e vlerës) me PO/JO. Mirëpo, aktiviteti si identifikim i fushave të inspektimit me prioritet të lartë në kuadër të planeve vjetore do të prodhojë një Plan Vjetor të Inspektimeve, kurse realizimi i inspektimeve të shpejta në fusha të ngushta dhe konkrete si dhe realizimi i inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, bazuar në vlerën e riskut, do të bëjë që të zhvillohen inspektime nga fushat të ndryshme inspektuese.

Objektivi 4. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Përgjithësisht zhvillimet kryesore që planifikohen të jenë në funksion të implementimit të aktiviteteve janë të fokusuara tek karakteri vendor e fokus të veçantë kanë implementimet e obligimeve që dalin nga memorandumet e bashkëpunimit si dhe disa nga to janë të karakterit ndërkombëtar, gjë e cila bën sfidues caktimin e saktë të nivelit të përmbushjes apo më mirë thënë të caktimit shprehës në numra apo përqindje të treguesve.

Andaj, aktivitetet e përcaktuara në këtë objektivi do të hyjnë në kategorinë e treguesit që janë (nën përjashtimin e vlerës) PO/JO. Përjashtimisht aktivitetit hartimi i raportit të Planit të Integritetit sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në ligjin për Agjencinë kundër Korrupsionit do të ketë një Raport vjetor që ndërlidhet me të dhënat sipas Planit të Integritetit.

3.Vlera bazë dhe vlera e synuar

Objektivi 1. Ngritja dhe profesionalizmi i punonjësve dhe fuqizimi i kapaciteteve të IPK-së

Vlera bazë parashihet të jetë 70%

Vlerë e synuar parashihet të jetë 80%

Objektivi 2. Sigurimi i transparencës së vazhdueshme lidhur me fushëveprimin ligjor të IPK-së

Vlera bazë parashihet të jetë 82%

Vlera e synuar parashihet të jetë 93%

Objektivi 3. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në pranimin e ankesave si dhe parandalimin, hetimin e veprave penale, shkeljeve disiplinore dhe inspektimeve sipas kompetencave ligjore të IPK-së

Vlera bazë parashihet të jetë 71%

Vlera e synuar parashihet të jetë 86%

Objektivi 4. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Vlera bazë parashihet të jetë 66%

Vlera e synuar parashihet të jetë 84%

4.Outputet

Për të përmbushur objektivat në Planin e Performacës dhe që aktivitetet kryesore të prodhojnë rezultatet përfundimtare, do të përgatiten për hartim dhe miratim të dokumentet siç janë: Plani Strategjik i Trajnimeve, Lista e Rrezeve dhe Plani i Integritetit, i cili do të jetë në përputhje me kërkesat ligjore që janë të parapa në Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Për më tutje, përmes njësive përgjegjëse nga Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme do të investohet në furnizimin me pajisje të teknologjisë informative, pajisjeve për realizimin e konferencave/takimeve virtuale, të cilat aktivitete ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe efektivitetin e përmbushjes së objektivave përmes aktiviteteve të listuara.

5.Aktivitetet

Objektivi 1. Ngritja dhe profesionalizmi i punonjësve dhe fuqizimi i kapaciteteve të IPK-së

Aktivitetet që do të planifikohen me qëllim të realizimit të këtij objekti janë:

Hartimi dhe miratimi i Analizës për Nevojat e Trajnimeve;

Zbatimi i Planit të trajnimeve;

Zhvillimi i procedurës së prokurimit dhe plotësimi i vendeve të lira konform ligjit për buxhet;

Aktiviteti i parë do të zbatohet në tremujorin e parë (TM 1) dhe përgjegjës për hartimin e këtij dokumenti do të jenë të angazhuara dhe përgjegjëse të gjitha departamentet: DH, DI, DMA, DPBÇL dhe DFSHP.

Aktiviteti i dytë do të zbatohet në vazhdimësi gjë që nënkupton përfshirjen e katër periodave (TM 01, TM02, TM03 dhe TM 04), kurse aktiviteti i tretë do të ketë mundësi që të zbatohet duke filluar në periudhën e dytë, tretë apo të katërt (TM 02 TM 03 dhe TM 04) dhe përgjegjës tek aktiviteti për plotësimin e vendeve të lira të punës përgjegjës do të jetë ZKE dhe DFSHP apo me konkretisht Njësia e Burimeve Njerëzore deri në zbatimin e Planit të Trajnimeve, përveç Njesisë së Burimeve Njerëzore si bartëse e këtij aktiviteti do të përfshihen edhe departamentet tjera në të cilat janë të shpërndarë punonjësit.

Objekti 2. Sigurimi i transparencës së vazhdueshme lidhur me fushëveprimin ligjor të IPK-së

Aktivitetet që do të ndërmerren për realizimin e këtij objekti janë:

Të ofrohet qasje e shpejtë dhe efikase në informatat me interes për publikun;
Azhurnimi në vazhdimësi i web-faqes zyrtare, rritja e raportimit online të punës së IPK-së;
Në përputhje me strategjinë e komunikimit të MPB-së, të realizohet komunikimi i strukturuar për informim efikas të publikut, duke u bazuar edhe në komunikimin strategjik;
Publikimi i Revistës “Integriteti”;
Publikimi i Buletinit “ Linja e Kaltër”;
Publikimi i “Raporteve të Inspektimit” përmes komunikatave për media ose organizimi i konferencave për shtyp ;
Aktivite në fushën e marrëdhënieve me publikun;
Mirëmbajtja dhe ngritja e nivelit të komunikimit me qytetarët përmes rrjeteve sociale;
Njoftimi i ankuesve për statusin e ankesave që trajtohen në IPK;
Aktiviteti i gjashtë do të zbatohet përgjatë tri periudhave kohore dhe atë duke filluar nga periudha e dytë dhe deri në të fundit (TM 02, TM03, dhe TM 04) dhe përgjegjës për realizimin e këtij aktiviteti është Departamenti i Inspektimeve s’bashku me Departamentin për Planifikim, Bashkëpunim Çështje Ligjore dhe Informim.

Aktiviteti i katërt do të zbatohet në tremujorin e fundit të vitit (TM 04) dhe përgjegjës për zhvillimin e këtij aktiviteti do të jetë Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim Çështje Ligjore dhe Informim.

Ndërsa shtatë nga aktivitetet tjera të listuara në këtë objektiv, do përfshijnë të gjitha periudhat e tre mujorëve e që nënkupton, se do të jenë në zbatimin e tyre në vazhdimësi (TM 01, TM 02, TM 03, TM 04).Përgjegjës për zhvillimin e këtyre aktivitetëve do të jenë të gjitha departamentet operative: DPBÇL, DH, DMA, dhe DI.

Objekti 3. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në pranimin e ankesave, parandalimin, hetimin e veprave penale, shkeljeve disiplinore dhe inspektimin sipas kompetencave ligjore të IPK-së

Aktivitetet që do të zhvillohen për realizimin e këtij objekti janë:

Zhvillimi i hetimeve preliminare nga Departamenti për Menaxhimin e Ankesave- DMA;
Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të pranimit dhe trajtimit të rasteve kur është e nevojshme dalja në vendin e ngjarjes apo raste kur kërkohen veprime urgjente;

Përcjellja e burimeve të hapura dhe adresimi i shkeljeve të dyshuara nga PK, sipas detyrës zyrtare;

Raste të hetuara dhe zyrtarë policor të hetuar;

Prioritizimi i hetimit për veprat penale bazuar në ndjeshmërinë dhe ndërlikueshmërinë e tyre;

Trajtimi i rasteve për shkak të incidenteve disiplinore të profilin të lartë si dhe hetimit disiplinor për shkelje të supozuara nga zyrtarët policor me grada të larta menaxheriale dhe ekzekutive;

Shenjëzimi i rasteve të dyshuara të korrupsionit;

Zvogëlimi i përqindjes së numrit të rasteve në DH që barten në vitin vijues;

Identifikimi i fushave të inspektimit me prioritet të lartë në kuadër të planeve vjetore;

Realizimi i inspektimeve të shpejta në fusha të ngushta dhe konkrete;

Realizimi i inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, bazuar në vlerësimin e riskut.

Aktiviteti i tetë me radhë do të zbatohet në tremujorin e katërt të vitit (TM 04) dhe përgjegjës për zhvillimin e këtij aktiviteti do të jetë Departamenti i Hetimeve.

Aktiviteti i nëntë me radhë do të zbatohet në tremujorin e parë vitit (TM 01) dhe përgjegjës për zhvillimin e këtij aktiviteti do të jetë Departamenti i Inspektimeve.

Ndërsa tetë nga aktivitetet tjera të listuara në këtë objektiv do përfshijnë të gjitha periudhat e tremujorëve që nënkupton do të jenë në zbatimin e tyre në vazhdimësi (TM 01, TM 02, TM 03, TM 04). Përgjegjës për zhvillimin e këtyre aktiviteteve do të jenë të gjitha departamentet operative: DH, DMA dhe DI.

Objekivi 4. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Strukturimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional;

Dorëzimi i rasteve në Avokaturën Shtetërore për përfaqësimin e institucionit në konteste gjyqësore;

Hartimi i raportit lidhur me Planin e Integritetit sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit;

Vazhdimi i implementimit të memorandumeve në fuqi dhe nënshkrimi i memorandumeve të reja me agjencitë tjera të linjës sipas nevojës;

Themelimi i ekipeve të përbashkëta të zhvillimit të operacioneve të përbashkëta me akterët vendor;

Angazhimi i mëtejshëm në ndërtimin e raporteve bilaterale me organizata ndërkombëtare të mbikëqyrjes policore dhe të sigurisë;

Vazhdimi i implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në fuqi si dhe angazhimi në lidhjen marrëveshjeve të reja me shtetet e rajonit dhe organizatave ndërkombëtare;

Themelimi i ekipeve të përbashkëta të hetimit/inspektimit me vendet e rajonit mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara apo të parimit të reciprocitetit;

Pjesëmarrja në konferencat e EPAC, NIAIA, konferenca ndërkombëtare, punëtori, dhe trajnime të ndryshme.

Aktiviteti i tretë me radhë do të përmbushet në periudhën e fundit (TM 04) dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim.

Aktiviteti i tetë me radhë do të realizohet në periudhën e tretë dhe të katërt (TM 03 dhe TM 04) dhe përgjegjës për përmbushjen e këtij aktiviteti do të jetë Departamenti i Inspektimeve dhe sipas nevojës (për shkak të natyrës së punës) mund të përfshihet edhe Departamenti i Hetimeve.

Ndërsa të gjitha aktivitetet tjera të listuara në këtë objektiv do përfshijnë të gjitha periudhat e tremujorëve, që nënkupton se do të jenë në zbatimin e tyre në vazhdimësi (TM 01, TM 02, TM 03, TM 04). Përgjegjës për zhvillimin e këtyre aktiviteteve do të jenë të gjitha departamentet e strukturës organizative.

6. Alokimi financiar

Për realizimin e të gjitha aktiviteteve nga katër objektivat, përgjithësisht kostoja financiare dhe e buxhetuar hyn në kategorinë e kostove² dhe atë tek kategoria ekonomike Paga dhe Shtesa, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale si dhe Projekte Kapitale, e të cilat në mënyrën tabelore do të përshkruhen në shifra/numra. Vlen të theksohet që disa nga aktivitetet përfshijnë kosto financiare të cilat mbështeten nga donacionet/donatorët.

7. Referenca në dokumente strategjike / politike

Plani i Performacës për vitin 2025, është hartuar duke u mbështetur në Planin Kombëtar për Zhvillim 2024-2026 si dhe në Planin Zhvillimor Strategjik 2022-2024 ku aktivitetet e përcaktuara në këtë plan do të inkorporohen në Planin Zhvillimor strategjik 2025-2027 të IPK-së. Duhet theksuar që hartimi i këtij dokumenti si proces do të jetë i mbikëqyrur dhe përkrahur edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe në këtë mënyrë do të ketë konfirmim se Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027 i IPK-së, do të jetë në harmoni me Planin Kombëtar për Zhvillim 2024-2026, si dhe Planin e Punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

² Kostot që përfshijnë kostot administrative janë bazuar në planifikimet buxhetore si dhe kufijtë buxhetor të përcaktuar komfor Qarkores Buxhetore 2025/02-MFPT, dhe në total për vitin 2025 arrijnë shumën prej 1,823,161.00 euro.

ANEKS I – Tabela e Planit të Veprimit

Objektivi	Treguesi	Vlera Bazë	Vlera e Synuar	Rezultate (Outputet)	Alokimet Financiare	Afati Kohor	Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike	Departamentet
1.Ngritja e profesionalizmit të punonjësve dhe fuqizimi i kapaciteteve të IPK-së	Hartimi i dokumentit PO	90%	100%	I. Hartimi dhe miratimi analizës për nevojat e	Donacion nga OSBE	TM 1	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026	DBNJ/ Të gjitha departamentet
	Trajnimi i burimeve njerëzore PO	80%	90%	II. Zbatimi i Planit të Trajnimeve	E buxhetuar ¹ Donacion	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026	DBNJ
	Procedurat e rekrutimit PO	40%	50%	III. Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për plotësimin e vendeve të lira konform dispozitave ligjore	E buxhetuar	TM 3 TM 4	Rregullore për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IPK	ZKE DFSHP/ Burimet Njerëzore

¹ Bazuar në kufijtë e qarkores buxhetore 2025/02

2.Të sigurohet transparencë e vazhdueshme lidhur me fushëveprimin ligjor të IPK-së	Numri i informimeve: PO	70%	80%	I. Të ofrohet qasje e shpejtë dhe efikase në informatat me interes për publikun	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027. ²	ZKE/ Të gjitha departamentet
	Azhurnimi Numri i raportimeve online: PO	80%	90%	II. Azhurnimi në vazhdimësi i webfaqes zyrtare, rritja e raportimit online të punës së IPK-së	Kosto Administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	DFSHP/ DPBÇLI
	Aktivitetet e përbashkëta: PO	80%	100%	III. Në përputhje me strategjinë e komunikimit të MPB-së të realizohet komunikimi i strukturuar për informim efikas	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	ZKE/ DPBÇLI
	Revista e Publikuar: 1 Revistë	90%	100%	IV. Publikimi i Revistës “Integriteti”	2300 €	TM 4	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	DPBÇL/ DFSHP

² Disa nga aktivitetet e përcaktuara në PZHS 2022-2024 do të inkorporohen në PZHS 2025-2027 aktivitete që do të vendosen si të paraprirë në Planin Performancës 2025

	Publikimi i Buletinit: 6 Buletini (çdo 2 muaj një buletin)	90%	100%	V. Publikimi i buletinit “ Linja e Kaltër”	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.	DPBÇLI
	Numri i raporteve dhe komunikatave për media: PO	80%	90%	VI. Publikimi i raporteve të inspektimit përmes komunikatave për media ose organizimi i konferencave për shtyp	Kosto administrative	TM 2 TM 3 TM4	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.	DPBÇLI, DI
	Numri i aktiviteteve PO	70%	80%	VII. Aktivitete në fushën e marrëdhënieve me publikun	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.	Të gjitha departamentet
	Mirëmbajtja e rrjeteve sociale PO	90%	100%	VIII.Mirëmbajtj a dhe ngritja e nivelit të komunikimit me qytetarët përmes rrjeteve sociale	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.	DPBÇLI

	Numri i njoftimeve për ankuesit/ të dëmtuarit: PO	85%	95%	IX. Njoftimi i ankuesve për statusin e ankesave që trajtohen në IPK.	1300€	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.	DMA/ DH
Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në pranimin e ankesave, hetimin e veprave penale shkeljeve disiplinore, inspektimeve sipas kompetencave ligjore	Numri i hetimeve preliminare: PO	50%	70%	I. Zhvillimi i hetimeve preliminare nga Departamenti për Menaxhimin e Ankesave- DMA	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.	DMA
	Numri i rasteve me dalje në vendin e ngjarjes dhe rasteve ku kërkohen veprime urgjente: PO	80%	100%	II. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të pranimin dhe trajtimit të rasteve kur është e nevojshme dalja në vendin	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.	DH
	Numri i rasteve të iniciuara sipas detyrës zyrtare: PO	80%	90%	III. Përcjellja e burimeve të hapura dhe adresimi i shkeljeve të dyshuara nga PK, sipas detyrës zyrtare	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	DPBÇLI, DH

	Numri i rasteve PO	70%	80%	IV.Raste të hetuara dhe zyrtarë policor të hetuar	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024- 2026.	DH
	Numri i rasteve të prioritizuara: PO	70%	80%	V. Prioritizimi i hetimit për veprat penale bazuar në ndjeshmërinë dhe ndërlikueshmëri në tyre	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024- 2026.	DH
	Numri i rasteve PO	60%	90%	VI. Trajtimi i rasteve për shkak të incidenteve disiplinore të profilit të lartë si dhe hetimit disiplinor për shkelje të	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.	DH
	Numri i rasteve të shenjëzuara: PO	70%	80%	VII. Shenjëzimi i rasteve të dyshuara të korrupsionit	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.	DH

	Përqindja e rasteve të përfunduara në DH: PO	60%	75%	VIII. Zvogëlimi i përqindjes së numrit të rasteve në DH që barten në vitin vijues	Kosto administrative	TM 4	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	DH
	Plani Vjetor i Inspektimeve/ 1 Plani Vjetor	80%	100%	IX. Identifikimi i fushave të inspektimit me prioritet të lartë në kuadër të planeve vjetore	Kosto administrative	TM 1	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.	DI
	Numri i inspektimeve të shpejta: PO	80%	90%	X. Realizimi i inspektimeve të shpejta në fusha të ngushta dhe konkrete	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.	DI
	Numri i inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme: PO	80%	90%	XI. Realizimi i inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme bazuar në vlerësimin e riskut	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.	DI

Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	Caktimi i personave përgjegjës dhe përcaktimi i formave të bashkëpunimit ndërinstitucional PO	70%	80%	I.Strukturimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	ZKE/DPBÇLI
	Numri i rasteve(shkresave përcjellëse) të dorëzuara: PO	90%	100%	II.Dorëzimi i rasteve në Avokaturën Shtetërore për përfaqësimin e institucionit lidhur me konteste givqësore	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	DPBÇLI
	Raporti i Planit të Integritetit: 1 Raport Vjetor	100%	100%	III.Hartimi i Raportit lidhur me Planin e Integritetit sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në ligjin për Agjencinë	Kosto administrative	TM 4	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	DPBÇLI
	Numri i memorandumeve të nënshkruara dhe numri i aktiviteteve për memorandum të reja: PO	50%	70%	IV. Vazhdimi i implementimit të memorandumeve në fuqi dhe nënshkrimi i memorandumeve të reja me agjencitë tiera	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	ZKE/DH DI

	Numri i hetimeve të përbashkëta: PO	50%	80%	V. Themelimi i ekipeve të përbashkëta të zhvillimit të operacioneve të përbashkëta me akterët vendor	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	ZKE
	Numri i aktiviteteve: PO	50%	80%	VI. Angazhimi i mëtejme në ndërtimin e raporteve bilaterale me organizata ndërkombëtare të mbikëqyrjes policore dhe të	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	ZKE/DPBÇLI
	Numri i aktiviteteve të përbashkëta dhe numri i angazhimeve për marrëveshje të reja: PO	60%	80%	VII. Vazhdimi i implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në fuqi si dhe angazhimi në lidhjen	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	ZKE
	Numri i ekipeve të përbashkëta: PO	60%	85%	VIII. Themelimi i ekipeve të përbashkëta të hetimit/inspektimit me vendet e rajonit mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.	DI/DH

	Pjesëmarrja: PO	60%	85%	IX. Pjesëmarrja në konferencat e EPAC, NIAIA, konferenca tjera ndërkombëtare , punëtori dhe trajnime të ndryshme	Kosto administrative/ Donacion	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.	ZKE
--	--------------------	-----	-----	--	--------------------------------------	------------	--	-----

ANEKS I – Tabela e Planit të Veprimit

Objektivi	Treguesi	Vlera Bazë	Vlera e Synuar	Rezultatet (Outputet)	Alokimet Financiare	Afati Kohor	Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike
1.Ngritja e profesionalizmit të punonjësve dhe fuqizimi i kapaciteteve të IPK-së.	Hartimi i Dokumentit PO	90%	100%	I. Hartimi dhe miratimi analizës për nevojat e	Donacion	TM 1	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.
	Trajnimi i burimeve njerëzore PO	80%	90%	II. Zbatimi i Planit të Trajnimeve	E buxhetuar ¹ Donacion	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.
	Procedurat e rekrutimit PO	40%	50%	III. Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për plotësimin e vendeve të lira/konform dispozitave ligjore.	E buxhetuar	TM2 TM 3 TM 4	Rregullore për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IPK.
2.Të sigurohet transparencë e vazhdueshme lidhur me fushëveprimin ligjor të IPK-së.	Numri i informimeve: PO	70%	80%	I. Të ofrohet qasje e shpejtë dhe efikase në informatat me interes për publikun.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027. ²

¹ Bazuar në kufijtë e qarkores buxhetore 2025/02

² Disa nga aktivitetet e përcaktuara në PZHS 2022-2024 do të inkorporohen në PZHS 2025-2027, aktivitete që do të vendosen si të paraprirë në Planin e Performancës 2025.

	Azhurnimi Numri i raportimeve online: PO	80%	90%	II. Azhurnimi në vazhdimësi i webfaqes zyrtare, rritja e raportimit online të punës së IPK-së.	Kosto Administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.
	Aktivitetet e përbashkëta: PO	80%	100%	III. Në përputhje me strategjinë komunikimit të MPB-së, të realizohet komunikimi i strukturuar për informim efikas të publikut	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027 .
	Revista e Publikuar/ 1 Revistë	90%	100%	IV. Publikimi i Revistës “Integriteti”	2300 €	TM 4	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.
	Publikimi i Buletinit/ 6 Buletine (çdo 2 muaj një buletin).	90%	100%	V. Publikimi i buletinit “ Linja e Kaltër”	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022- 2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025- 2027.

	Numri i raporteve dhe komunikatave për media: PO	80%	90%	VI. Publikimi i raporteve të inspektimit përmes komunikatave për media ose organizimi i konferencave për shtyp.	Kosto administrative	TM 2 TM 3 TM4	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027 .
	Numri i aktiviteteve: PO	70%	80%	VII. Aktivitete në fushën e marrëdhënieve me publikun.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Mirëmbajtja e rrjeteve sociale PO	90%	100%	VIII. Mirëmbajtja dhe ngritja e nivelit të komunikimit me qytetarët përmes rrjeteve sociale.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024 - Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Numri i njoftimeve për ankuesit/ të dëmtuarit: PO	85%	95%	IX. Njoftimi i ankuesve për statusin e ankesave që trajtohen në IPK.	1300€	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.

Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në pranimin e ankesave, hetimin e veprave penale shkeljeve disiplinore, inspektimeve sipas kompetencave ligjore.	Numri i hetimeve preliminare: PO	50%	70%	I. Zhvillimi i hetimeve preliminare nga Departamenti për Menaxhimin e Ankesave- DMA	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.
	Numri i rasteve me dalje në vendin e ngjarjes dhe rasteve ku kërkohen veprime urgjente: PO	80%	100%	II. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të pranimin dhe trajtimit të rasteve kur është e nevojshme dalja në vendin	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.
	Numri i rasteve të iniciuara sipas detyrës zyrtare: PO	80%	90%	III. Përcjellja e burimeve të hapura dhe adresimi i shkeljeve të dyshuara nga PK, sipas detyrës zyrtare.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.
	Numri i rasteve: PO	70%	80%	IV. Raste të hetuara dhe zyrtarë policor të hetuar.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.

	Numri i rasteve të prioritizuara: PO	70%	80%	V. Prioritizimi i hetimit për veprat penale bazuar në ndjeshmërinë dhe ndërlíkueshmërinë e tyre.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.
	Numri i rasteve: PO	60%	90%	VI. Trajtimi i rasteve për shkak të incidenteve disiplinore të profilit të lartë si dhe hetimit disiplinor për shkelje të	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Numri i rasteve të she njëzuara: PO	70%	80%	VII. She njëzimi i rasteve të dyshuara të korrupsionit.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Përqindja e rasteve të përfunduara në DH: PO	60%	75%	VIII. Zvogëlimi i përqindjes së numrit të rasteve në DH që barten në vitin vijues.	Kosto administrative	TM 4	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.

	Plani Vjetor i Inspektimeve/ 1 Plani Vjetor	80%	100%	IX. Identifikimi i fushave të inspektimit me prioritet të lartë në kuadër të planeve vjetore.	Kosto administrative	TM 1	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.
	Numri i inspektimeve të shpejta: PO	80%	90%	X. Realizimi i inspektimeve të shpejta në fusha të ngushta dhe konkrete.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.
	Numri i inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme: PO	80%	90%	XI. Realizimi i inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme bazuar në vlerësimin e riskut.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026.
Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	Caktimi i personave përgjegjës dhe përcaktimi i formave të bashkëpunimit ndërinstitucional PO	70%	80%	II. Strukturimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.

	Numri i rasteve (shkresave përcjellëse) të dorëzuara: PO	90%	100%	II. Dorëzimi i rasteve në Avokaturën Shtetërore për përfaqësimin e institucionit lidhur me konteste givqësore.	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Raporti i Planit të Integritetit/ 1 Raport Vjetor	100%	100%	III. Hartimi i Planit të Integritetit sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në ligjin për Agjencinë kundër	Kosto administrative	TM 4	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Numri i memorandumeve të nënshkruara dhe numri i aktiviteteve për memorandum të reja: PO	50%	70%	IV. Vazhdimi i implementimit të memorandumeve në fuqi dhe nënshkrimi i memorandumeve të reja me agjencitë tjera	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Numri i hetimeve të përbashkëta: PO	50%	80%	V. Themelimi i ekipeve të përbashkëta të zhvillimit të operacioneve të përbashkëta me akterët vendor	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.

	Numri i aktiviteteve: PO	50%	80%	VI. Angazhimi i mëtëjm në ndërtimin e raporteve bilaterale me organizata ndërkombëtare të mbikëqyrjes policore dhe të	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Numri i aktiviteteve të përbashkëta dhe numri i angazhimeve për marrëveshje të reja: PO	60%	80%	VII. Vazhdimi i implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në fuqi si dhe angazhimi në lidhjen	Kosto administrative	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Numri i ekipeve të përbashkëta: PO	60%	85%	VIII. Themelimi i ekipeve të përbashkëta të hetimit/inspektimit me vendet e rajonit mbi bazën e marrëveshje të nënshkruara	Kosto administrative	TM3- TM4	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.
	Pjesëmarrja: PO	60%	85%	IX. Pjesëmarrja në konferencat e EPAC,NIAIA, konferenca tjera ndërkombëtare , punëtori dhe trajnime të ndryshme	Kosto administrative/ Donacion	Vazhdimësi	Plani Zhvillimor Strategjik 2022-2024- Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027.